

POLITIKA E CILËSISË DHE SIGURISË SË INFORMACIONIT

Synimi i kompanisë DAISY&ETM Sh.Th është të:

- Ofrojë zgjidhje softwarike fiskale dhe pajisje elektronike me një cilësi të lartë, që do të përdoren nga tatimpaguesit Shqiptar, konform ligjit në fuqi “Për Faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit” për të plotësuar nevojat e klientëve.
- Zhvillojë vazhdimisht Zgjidhjet Softwarike Fiksale dhe Shërbimin IT si përparësi konkurrese në drejtim të ofrimit të shërbimit cilësor dhe pa ndërprerje për klientët tanë.
- Përgjigjet në kohë kërkesave të klienteve.
- Arrijë nivelin më të lartë të kënaqësisë së klientit duke tejkaluar pritshmëritë e tyre për produktet dhe shërbimet që DAISY&ETM Sh.Th ofron.
- Kontribuojë në zhvillimin, efikasitetin dhe produktivitetin e klientëve tanë.
- Përdorë të dhënat për të përmirësuar shërbimet tona nëpërmjet informacioneve më të mira, me qëllim ofrimin e shërbimeve të lëvruara në kohë, cilësore dhe brenda buxhetit.
- Krijojë dhe mirëmbajë pozicionin si “partner i besuar” për klientët e mundshëm dhe autoritetet që ata kanë.

Për të arritur këtë synim, kompania DAISY&ETM Sh.Th është përkushtuar në:

- Ofrimin Zgjidhjeve Softwarike Fiskale dhe Shërbimin IT në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, standardet dhe praktikat e rekomanduara
- Garanton kapacitete të mjaftueshme dhe disponueshmëri të lartë të burimeve dhe pajisjeve për të siguruar ofrimin e shërbimeve
- Verifikon dhe siguron cilësinë e shërbimeve dhe produkteve sipas kërkesave dhe garanton Shërbime IT që nuk dështojnë
- Mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë, Shërbimit IT, dhe Sigurisë së informacionit sipas standardeve ISO 9001:2015, ISO 20000-1:2018 dhe ISO/IEC 27001:2013 për të krijuar një sistem analizues nëpërmjet informacionit të dokumentuar
- Kontrollin e zbatimit të politikave të kompanisë nëpërmjet rezultateve të auditimeve nga Trupa Certifikuese, auditimeve të brendshme, rishikimit të menaxhimit, feedback-ut të klientëve dhe auditimet nga klientët
- Mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit në kulturën e saj dhe praktikat ditore si një përkushtim afatgjatë kundrejt përmirësimit të vazhdueshëm dhe kënaqësisë së palëve të interesuara
- Zbatimin e Sistemit të Menaxhimit pa shmangie dhe mangësira nga i gjithë stafi i kompanisë
- Sigurimin e kompetencës teknike të stafit nëpërmjet rekrutimit të një personeli të kualifikuar, trajnimit të vazhdueshëm, monitorimit, vlerësimit të arritjeve individuale të personelit
- Shqyrtimin e rreziqeve dhe mundësive që lidhen me aktivitetet e kompanisë, me qëllim që të sigurohet se Sistemi i Menaxhimit arrin rezultatet e synuara dhe parandalimin e ndikimeve të padëshiruara dhe dështimet e mundshme
- Sigurimin e të kuptuarit dhe përputhjes me kërkesat përkatëse statusore, ligjore, rregullatore dhe kontraktuale në funksionet brenda mjedisit të punës, në të cilat aderon

- **POLITIKA E SIGURISË SË INFORMACIONIT**

- **Qëllimi**

Kompania udhëhiqet nga parimi i mbrojtjes së informacionit. Stafi ynë është kualifikuar dhe motivuar për të kryer në një nivel modern dhe profesional të gjitha detyrat e sigurimit të informacionit dhe mbrojtjes së individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të të dhënave të tilla. Çdo punonjës është i vetëdijshëm për rëndësinë e veprimeve të tyre dhe merr pjesë aktive në procesin e përmirësimit të sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit.

- **Fusha e zbatimit**

Kjo politikë zbatohet për të gjithë punonjësit e DAISY&ETM, institucionet shtetërore apo kompanite private dhe atyre që përdorin objektet dhe informacionin e saj. Pajtueshmëria me Politikën e Sigurisë së Informacionit do të jetë pjesë e kontratës së punësimit. Mospërputhja me Politikën e Sigurisë së Informacionit përbën shkelje dhe do të trajtohet si një çështje disiplinore. Përgjegjësi i Sektorit të IT-së, ka përgjegjësinë për vendimet lidhur me zbatimin e kësaj politike, duke përdorur procedurat disiplinore në dispozicion e tij/saj, si të jetë më e përshtatshme. DAISY&ETM do të inkurajojë miratimin dhe përdorimin e kësaj Politike të Sigurisë së Informacionit nga palët e treta që bashkëpunojnë në sipërmarrjet e përbashkëta.

- **Përshkrimi**

Informacioni, është një burim për DAISY&ETM, pa të cilin pothuajse të gjitha aktivitetet tona do të ishin të pamundura. Informacioni përfshin: klientet (popullin), sistemet, të dhënat e klienteve; të dhënat administrative, të dhënat e personelit dhe të dhënat financiare; rrjetin e brendshëm kompjuterik, sistemet e bazës së të dhënave; analiza; publikime dhe referenca. Informacioni mund të ekzistojë në shumë forma. Mund të jetë i printuar, i shkruar në letër, i ruajtur në forme elektronike. Ai mund të transmetohet me postë ose me mjete elektronike, paraqitur në filmime apo prezantime, ose mund të transmetohet nëpërmjet një bisede. Çfarëdo forme të kësaj informacioni apo në çfarëdo mënyre të jetë ai, DAISY&ETM merr masat për mbrojtjen maksimale të tij. DAISY&ETM duhet të përpiqet të beje gjithçka që mundet për të mbrojtur asetet e tij të informacionit në mënyra që janë të përshtatshme dhe efektive. Kjo e ndihmon DAISY&ETM për të përmbushur përgjegjësitë e tij dhe për t'i mundësuar stafit një veprimtari normale dhe të sigurt. Aftësia jonë për të marrë, zhvilluar, analizuar dhe publikuar dhe për të mbrojtur të dhënat tona do të na mundësojë ngritjen e një reputacioni, si organizate e cila i jep rëndësi maksimale mbrojtjes së sigurisë së informacionit, duke zbatuar rigorozisht direktivat e standardeve ndërkombëtare ISO 27001 dhe direktivave të vendosura nga Komisioneri për Mbrojtjen e Të Dhënave Personale.

- **Objektiva**

Objektivi i sigurisë është që të mbrojmë DAISY&ETM nga problemet e sigurisë së informacionit që mund të kenë një efekt negativ në operacionet tona dhe gjenden tonë profesionale, si dhe në reputacionin tonë si organizate. Problemet e sigurisë mund të përfshijnë konfidencialitetin (individin, marrjen apo dhenien e informacioneve shpjeguese të papërshtatshme), integritetin (informacioni të ndryshohet qëllimisht ose gabimisht) dhe disponueshmërinë (informacioni nuk është në dispozicion kur është i nevojshme). Një përkufizim i gjerë i sigurisë, do të përdoret për të përfshirë të gjitha llojet e incidenteve që perbejnë një kërcënim për përdorimin efektiv të informacionit IT.

- **Përdorimi**

Përdorimi i të gjitha masave të arsyeshme, të përshtatshme, praktike dhe efektive të sigurisë për të mbrojtur proceset e rëndësishme dhe aktivitetin për arritjen e objektivit të sigurisë. Përdorimi i ISO/IEC 27001:2013 Teknologji informacioni – Teknikat e sigurisë – Kodi i Praktikës për Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit. Vazhdimisht shqyrtojmë përdorimin e masave të sigurisë, në mënyrë që të përmirësojmë mbrojtjen institucionale. Mbrojmë dhe menaxhojmë asetet e informacionit, gjë e cila mundeson përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, legjislative, reputacionin dhe përgjegjësitë etike. Si një organizatë që ofron shërbime ne të gjithë Territorin e Republikës së Shqipërisë, jemi të vetëdijshëm për nevojën e mbrojtjes së sigurisë së informacionit, si dhe për transparencën që duhet të kemi me Klientin.

- **Përgjegjësitë**

I gjithë personeli i përhershëm dhe i përkohshëm, i DAISY&ETM ka detyrimin të mbrojtë pasuritë e informacioneve, sistemet dhe infrastrukturën. Ata, në çdo kohë, veprojnë në një mënyrë të përgjegjshme, profesionale të sigurtë, të vetëdijshme dhe që përputhet me këtë politikë . Gjithkush do të respektojë asetet e informacionit të palëve të treta. Një mbrojtje e tillë kërkohet me kontratë, me ligj ose nga ana etike. Punonjësit e DAISY&ETM janë përgjegjës për identifikimin e mangësive të sigurisë në praktikën dhe/ose përmirësimet që mund të bëhen në politikën tona ekzistuese të sigurisë. Raportimi i tyre behet te Menaxheri i IT-se. Identifikimi i rreziqeve të sigurisë së informacionit me prioritet, duke u përgjigjur menjëherë, duke zbatuar masat mbrojtëse të cilat janë të përshtatshme, efektive dhe praktike. Të gjithë punonjësit e DAISY&ETM janë përgjegjës për veprimet e tyre në lidhje me sigurinë e informacionit. Të gjitha informacionet (duke përfshirë informacionet e palës së treta), do të jenë të mbrojtur nga kontrollat e sigurisë dhe procedurat e trajtimit të informacioneve sensitive. Kur është e nevojshme nga marrëveshjet kontraktuale apo nga urdhri i gjykatës ose prokurorisë, informacioni do të jepet për institucionet apo shoqëritë nga DAISY&ETM, duke firmosur një marrëveshje konfidencialiteti. Incidentet aktuale ose veprimet që dyshohen të jenë si incident i sigurisë së informacionit IT, raportohen menjëherë në Sektorin e IT-së, ku menaxhohen incidentet, analizohen shkaqet, si dhe nxirren mesime se çfarë do të bëhet që të mos ndodhin në të ardhmen.

- **Rishikimi i politikës së sigurisë së informacionit / personat përgjegjës**

Përfaqësuesit e DAISY&ETM krijojnë këtë Politikë të Sigurisë së Informacionit dhe angazhohen në zbatimin e saj. Ata mundësojnë shqyrtimin vjetor të saj nga Sektori i Teknologjisë së Informacionit. Kjo politikë rishikohet për plotësinë, efektivitetin dhe përdorshmërinë. Efektiviteti matet me aftësinë e DAISY&ETM për të shmangur incidentet e sigurisë dhe për të minimizuar ndikimet që rezultojnë. Administratori i DAISY&ETM si dhe Përgjegjësi i Sektorit IT, do të nënshkruajnë të gjitha versionet e reja të Politikës së Sigurimit të Informacionit. Punonjësit e DAISY&ETM janë përgjegjës për identifikimin e mënyrave në të cilat Politika Sigurimit të Informacionit të mund të permiresohet. Sugjerimet për permiresim, duhet të dërgohen pranë Sektorit IT. Nëqoftëse ndryshimet duhen bërë në mënyrë të menjëhershme, kërkohet një takim i vecantë me menaxherin e sigurisë së informacionit, përndryshe sugjerimet do të diskutohen në takimin e rishikimit vjetor të Politikës. Politika e sigurisë së informacionit rishikohet në intervale kohe të planifikuar ose jashtë planifikimit nëse ndodhin ndryshime të rëndësishme për të siguruar përdorshmërinë, përshtatshmërinë dhe efektivitetin e tyre të vazhdueshëm. Ajo aprovohet nga Administratori i kompanisë, behet e njohur për të gjithë punonjësit dhe të gjitha palet që kanë lidhje me kompaninë. Kjo politikë e rishikuar publikohet në faqen e Web të Daisy&Etm .

- **Shpërndarja**

Një kopje e kësaj politike do të vihet në dispozicion për të gjithë personelin e punësuar aktualisht, ose kur ata fillojnë punë pranë DAISY&ETM. Seksione individuale të politikës do të jenë të përditësuara si dhe do të jenë të publikuara në faqen e web-it të DAISY&ETM . Të gjithë punonjësit si dhe institucionet shtetërore apo kompanitë private që kanë bashkëpunim me DAISY&ETM pritet të jenë në djeni të kësaj politike, si dhe të veprojnë në përputhje me të në çdo kohë. Përgjegjësi i Sektorit IT, ka përgjegjësinë për interpretimin dhe sqarimin e Politikës së Sigurimit të Informacionit. Çdo punonjës që kërkon informacion të mëtejshëm mbi çdo aspekt të kësaj politike duhet të diskutojë nevojat e tij me përgjegjësën e Sektorit të IT-së.